



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:275583
Datë: 12.12.2024
Numri i dokumentit: 06592157

C.nr. 2524/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunatoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.H., Gj. T., Xh. G., T.M., B.Zh., që të gjithë nga Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Qëndresa Bytyqi Hoxha, lidhur me çështjen kontestuese kompensimin e diferencës në pagë në emër të kualifikimit, jashtë seance, me datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës-Drejtoria Komunale e Arsimit që:

- 1) Paditësi: A.H. në emër të kualifikimit bachelor, të ia paguaj shtesat prej 35 %, të një page pagës bazë, për periudhën kohore prej 01.02.2023 deri më 30.06.2024, respektivisht për 17 muaj, në shumën e tërësishme prej 3,684.45 euro.
- 2) Paditësi: Gj. T. në emër të kualifikimit bachelor, të ia paguaj shtesat prej 35 %, të një page pagës bazë, për periudhën kohore prej 01.02.2023 deri më 30.06.2024, respektivisht për 17 muaj, në shumën e tërësishme prej 3,684.45 euro.
- 3) Paditësit: Xh. G. në emër të kualifikimit bachelor, të ia paguaj shtesat prej 35 %, të një page pagës bazë, për periudhën kohore prej 01.02.2023 deri më 30.06.2024, respektivisht për 17 muaj, në shumën e tërësishme prej 3,684.45 euro.
- 4) Paditësit: T.M. në emër të kualifikimit bachelor, të ia paguaj shtesat prej 27 %, të një page pagës bazë, për periudhën kohore prej 01.02.2023 deri më 30.06.2024, respektivisht për 17 muaj, në shumën e tërësishme prej 2,842.29 euro.

- 5) Paditëses: B.Zh. në emër të kualifikimit bachelor, të ia paguaj shtesat prej 35 %, të një page pagës bazë, për periudhën kohore prej 01.02.2023 deri më 30.06.2024, respektivisht për 17 muaj, në shumën e tërësishme prej 3,684.45 euro.

Të gjitha këto me kamatë prej 8% në vit nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit A.H., Gj. T., Xh. G., T.M., B.Zh., që të gjithë nga Komuna e Gjakovës përmes të autorizuarit të tyre, Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 09.08.2024, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e diferencës në pagë mujore mbi bazën e kualifikimit. Duke theksuar se paditësit janë të punësuar pranë të paditurës në bazë të kontratës së punës, në pozitat e mësimdhënësve, të njëjtin janë të diplomuar dhe kanë kualifikim bachelor.. Më tej ka theksuar se duke qenë se Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO79/23 të datës 23.01.2024 ka shfuqizuar nenin 45 par. 2 të Ligjit për pagat në sektorin publik, tani paditësit i takon shtesa në emër të kualifikimit si përcaktohet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 të datës 29.08.2008. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditësve dhe të detyrohet e paditura që paditësve t'i paguajë shtesat në emër të kualifikimit nga data 01.02.2023 deri me datë 30.06.2024, për 17 muaj në lartësi prej 35 % të një page bazë, respektivisht në shumë prej 158.76 euro në muaj, kurse për vitin 2024 paditësve ju takon kompensimi shtesë në lartësi prej 166.32 euro në muaj për, po ashtu kanë kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Qëndresa Bytyqi Hoxha, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 06.12.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se nga provat e prezantuar – listat e pagave të paditësit shihet se sa i përket shtesave nga e paditura mbi bazën e kualifikimit, të njëjtat përmbushen çdo muaj. Kërkesës së paditësit i mungon baza pasi që kjo e drejtë nuk i takon me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës. Sa i përket Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 i datës 29.08.2008, në asnjë pikë të tij nuk ekziston ndonjë detyrim të cilin Komuna e Gjakovës duhet ta përmbushë. Edhe nëse do të kishte, Qeveria nuk e ka mbështetur të paditurën me mjete financiare për ta përmbushur detyrimin e pretenduar. Periudha e kërkuar nga data 01.02.2023 deri me datë 31.07.2024 është e pamundur të realizohet pasi që pretendimet e paditësit për periudhën e lartcekur të cilat mbështeten në Vendimin e Qeverisë Nr.01/33 të datës 29.08.2008, nuk janë të qëndrueshme.

Ky vendim nuk gjene bazim pas datës 06.02.2023, kur u shfuqizua me ligjin e pagave në Sektorin Publik Nr.08/L-196.Çdo kërkesë e e bërë pas kësaj date nuk ka mbështetje ligjore, pasi që një vendim i shfuqizuar nuk mund të prodhojë efekt juridike duke pretenduar që pretendimet e paditëses janë të paqëndrueshëm dhe jashtë ligjore. Tutje ka konsideruar se në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses është parashkruar në tërësi, e po ashtu i njëjti as nuk i ka shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Po ashtu ka shtuar se bazuar në praktikat e deritanishme nga të gjitha instancat e Republikës së Kosovës, kompensimet e tilla kanë karakter deklarativ e jo detyrues, kjo për shkak se lihet në diskrecion të palëve kontraktuese të gjendet mundësia financiare. Tutje ka theksuar se ka indikacione që kemi të bëjmë me rast të gjykuar, ku ka kërkuar nga gjykata verifikimin e kësaj rrethane. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pabazë dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se ne mes të palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësit janë të punësuar tek e paditura dhe gëzonin shpërblim në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të Kontratës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësi Agron Haliti, është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024, vërtetohet fakti se realizon pagë bazë në lartësi prej 616.00 euro, e njëjta ka diplomuar me datë 14.07.2008, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, numër 24, me datë 04.12.2008.

Në bazë të Kontratës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësi Gjokë Tahri, është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Hysni Zajmi” në Gjakovë. I njëjti ka diplomuar me datë 18.07.1992, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike, numër 37, me datë 02.12.1994.

Në bazë të Kontratës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësi B.Zh. Meka, është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024, vërtetohet fakti se realizon pagë bazë në lartësi prej 638.00 euro.

Në bazë të Kontratës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësi T.M., është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024, vërtetohet fakti se realizon pagë bazë në lartësi prej 638.00 euro, e njëjta ka diplomuar me

datë 25.11.1988, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, numër 5052, me datë 20.03.1989.

Në bazë të Vendimit të lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësi Xh. G. është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024, vërtetohet fakti se realizon pagë bazë në lartësi prej 682.00 euro, e njëjta ka diplomuar me datë 14.07.2008, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universitetit të Tetovës, Fakulteti i Shkencave Matematikore numër 1184, me datë 02.10.2020.

Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Fillimisht Gjykata gjen se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 të datës 29.08.2008, përcaktohet se *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Tutje, ky vendim ka përcaktuar se *“Nga 1 shtatori 2008, përmes licencimit zëvendësohet sistemi linear i pagave përmes dallimeve pozitive të pagave për të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm”*.

Me datë 05.02.2023, ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik. Në nenin 1 ky Ligj ka përcaktuar se *“qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë”*. Tutje, Ligji në nenin 3 par. 1 nënpar. 1.9 ka përkufizuar pagën bazë si vijon: *“paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji.”* Më tej, në nenin 29 par. 1 të Ligjit është përcaktuar se *Nëpunëset/it e arsimit parauniversitar mund të marrin shtesën për licencë të avancuar. Shtesa për licencë të avancuar nuk nënkupton licencën e nivelin bazik që njihet si licencë e karrierës e që është kusht për ushtrimin e profesionit.*

Gjykata konstaton se Vendimi i Qeverisë numër 01/33 i datës 29.08.2008 në kohën e hyrjes së tij në fuqi ka ngritur pagat e nëpunësve të arsimit parauniversitar (mësimdhënësve, drejtorëve (zëvendësdrejtorëve) dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm), ashtu që përmes licencimit është zëvendësuar sistemi linear i

pagave përmes dallimeve pozitive të pagave. Pra, ngritja e pagave për këtë kategori është bërë me vendim qeveritar, për shkak të mungesës së një ligji për pagat në sektor publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik me datë 05.02.2023, është krijuar një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, ku përfshihen edhe nëpunësit e sistemit arsimor parauniversitar. Së këndejmi, me këtë ligj është përcaktuar paga bazë edhe për nëpunësit e sistemit arsimor parauniversitar e cila i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Në këtë kuptim, Vendimi i Qeverisë numër 01/33 i datës 29.08.2008 ka zëvendësuar sistemin linear të pagave me rastin e hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, është krijuar sistem i ri i pagave, ku është përcaktuar paga bazë. Andaj, duke qenë se në pagën bazë të nëpunësve të arsimit parauniversitar është përfshirë edhe kualifikimi i kërkuar për ushtrimin e funksionit, gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara nuk rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Së këndejmi, gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin nga pika II e dispozitivit që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale, gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura e konform nenit 399 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.2524/24, datë 12.12.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.